



Breaking News:

Shkencë: Vendi më i rrezikshëm në Evropë për vrasje të policëve në punë

|| << >>



21/03/2023

Tiranë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Safe”

Tiranë

Falë ndërhyrjes në kohë të shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 3, u parandalua një ngjarje e rëndë kriminale në familje.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Safe”, sekuestrohen 2 armë zjarri dhe municion luftarak.

Ushtroi dhunë fizike dhe kanosi me armë zjarri vëllanë e tij dhe dajën, arrestohet në flagrancë 31-vjeçari.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, pas njoftimit për një shtetas që mbante armë zjarri në banesë dhe kanoste familjarët e tij, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Safe”, për të parandaluar ngjarjen e mundshme kriminale.

Falë ndërhyrjes në kohë, shërbimet e Policisë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin I. M., 31 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje.

Nga veprimet hetimore dyshohet se ky shtetas ka ushtruar dhunë fizike në mënyrë të përsëritur ndaj vëllait të tij dhe dajës së tyre, si dhe i ka kanosur ata me armë zjarri, për motive të dobëta.

Gjatë kontrollit në ambientet e banesës së shtetasit I. M. janë gjetur të fshehura 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë zjarri automatik, 2 krehra dhe municion luftarak.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



◀ Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Afternoon”,

DVP Elbasan – Procedohen penalisht 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale ▶

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent